



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më 01.02.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik **“HASTOÇI” shpk** me NIPT J62028009B me adrese Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Pjeter Bogdani, Pallati nr.17, Apartamenti 5/3, perballe Kopshtit nr.31, me administrator Z. Mynyr Hastoçi.

Procedura e prokurimit: “Procedure e hapur – pune”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81828-12-11-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza Lagjia e ish zyrat e Ndërmarrjes së Kromit, Qytetit Prrenjas, Bashkia Prrenjas”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.122 datë 21 Dhjetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Fondi limit: 17.876.413 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **BOE HELIOS NDERTIM shpk & UDHA shpk** ; HELIOS NDERTIM shpk me NIPT L64507603U dhe UDHA shpk me NIPT K77524909Q, me oferte ekonomike 12.536.468 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tete) leke pa tvsh

2.**BOE “2 Z KONSTRUKSION” shpk & “I.C.C GROUP” shpk**, perkatesisht OE 2Z “KONSTRUKSION” shpk me NIPT J63229466K dhe “ I.C.C GROUP” shpk me NIPT L51308006A, me oferte ekonomike 15.032.955 (pesëmbëdhjetë milion e tridhjetë e dy mijë e nentëqind e pesëdhjetë e pese) leke pa tvsh.

3. **BAJRAMI N shpk** me NIPT K027272020, me oferte ekonomike 13.939.197,3 (trembëdhjetë milion e nentëqind e tridhjetë e nente mijë e njëqind e nentëdhjetë e shtate presje tre) leke pa tvsh.

4.**BOE “LOSHI BL” shpk & “DELIA IMPEX” shpk & “AGBES KONSTRUKSION”** ; LOSHI BL shpk me NIPT J67902618M, dhe DELIA IMPEX shpk me NIPT K57123001R, me oferte ekonomike 15.436.260 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) leke pa tvsh.

5.**LEON KONSTRUKSION** shpk me NIPT K71820009I , me oferte ekonomike 15.722.521 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e njëzet e një) leke pa tvsh

6.”BE-IS” shpk me NIPT K71412003A, , vlera e ofertes ekonomike 16.083.375 (gjashtembedhjete milion e tetedhjete e tre mije e treqind e shtatedhjete e pese) leke pa tvsh.

7. **“HASTOÇI shpk** me NIPT J62028009B, me oferte ekonomike 15.156.729 (pesembedhjete milion e njeqind e pesedhjete e gjashte mije e shtateqind e njezet e nente) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **BOE HELIOS NDERTIM shpk & UDHA shpk** ; HELIOS NDERTIM shpk me NIPT L64507603U dhe UDHA shpk me NIPT K77524909Q.

2.**BOE “2 Z KONSTRUKSION” shpk & “I.C.C GROUP” shpk**, perkatesisht OE 2Z “KONSTRUKSION” shpk me NIPT J63229466K dhe “ **I.C.C GROUP” shpk** me NIPT L51308006A.

3. **BAJRAMI N shpk** me NIPT K02727202O.

4.**BOE “LOSHI BL” shpk & “DELIA IMPEX” shpk & “AGBES KONSTRUKSION”** ; LOSHI BL shpk me NIPT J67902618M , dhe DELIA IMPEX shpk me NIPT K57123001R .

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. BOE “HELIOS NDERTIM” shpk & “UDHA” shpk

Arsyeja e skualifikimit:

Nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kritereve te vecanta per kualifikim sic jane percaktuar ne shtojca 12 e DST .

1.1 Nje prej pjesetareve te ketij BOE , konkretisht **“HELIOS NDERTIM” shpk**, nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte qe te deshmoje plotesimin e pikes 2.1.gj te kritereve te vecanta per kualifikim , *shtojca 12 e DST* .

Ne kete pike eshte kerkuar ;

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri , operatori ka paraqitur vertetimin e leshuar nga OSHE, ne te cilin deshmohet se eshte paguar detyrimi i muajit tetor 2020 dhe nuk eshte perfshire muaji nentor 2020. Detyrimi i muajit nentor 2020 eshte maturuar dhe operatori ka patur detyrimin ta paguante deri me 31.12.2020 .

Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit 13.01.2021 dhe Nenit 9, paragrafi 1 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “*Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë*”, ky operator nuk ka përmbushur e detyrimet ligjore për shlyerjen detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, detyrimet e energjisë elektrike për muajin nentor 2020 eshte maturuar .

1.2 Nje prej pjesetareve te ketij BOE , konkretisht **“HELIOS NDERTIM” shpk**, nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte qe te deshmoje plotesimin e pikes 1.d te kritereve te pergjithshme

per kualifikim , shtojca 12 e DST . *(nuk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.)*

Ky operator ka dorezuar , vertetimin e leshuar nga organi tatimor date 12.01.2021 ku deshmohet se ka detyrime te papaguara per kontributet e sigurimeve shoqerore ne shumen 75 888 leke .

1.3 Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.4/d te kriterëve te vecanata per kualifikim , shtojca 12 e DST.

Ne kete pike eshte kerkuar ;

d. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne liste pagesat e shoqërisë te pakten muajin e fundit 6 (gjashte) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik leshuar nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, te akredituara sipas legjislacionit ne fuqi, si dhe deshmi te kualifikimit profesional ku nga keta te jene te pakten:

-2(dy) hidraulike, 1(hidroizolues), 3 (tre kartpentiere). (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit profesional, deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) si dhe te jene ne liste pagesen e shoqerise per muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri , operatori ekonomik **“HELIOS NDERTIM”** sh.p.k ka paraqitur në SEP vetem kontratat e punes dhe deshmi te sigurimit teknik por jo deshmi aftesimi profesional ne profesionet e kerkuara hidraulike, hidroizolues dhe kartpentiere, ndersa operatori ekonomik “UDHA” shpk, ka paraqitur deshmi kualifikimi profesional te leshuara nga AQSCERT .

Ne kete rast , KVO ka zbatuar praktiken e vendimarrjes se KPP , si organi me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve publike, vendimet e te cilit jane te detyrueshme per zbatim nga cdo AK qe prokuron fonde publike . Konkretisht VENDIM K.P.P. 706/2019 ku operatori MANE S shpk eshte skualifikuar pikerisht dhe vetem per arsyen qe po skualifikohet edhe ky BOE.Po keshu edhe vendimi KPP.343/2020 ,etj.

Gjithashtu edhe deshmitë e leshuara nga Aqscert shpk e te paraqitura nga operatori ekonomik “Udha” shpk jane te pavlefshme sepse shoqeria ASQCERT, nuk eshte licensuar nga ana Ministrise se Financave dhe Ekonomise dhe nuk disponon asnje license per te ofruar kurse trajnimi per formimin profesional ne perputhje me ligjin nr.15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise.”

1.4 Nje prej pjesetareve te ketij BOE, konkretisht operatori “Helios Ndertim” shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim .

Nuk ka aritur te paraqese dokumentacion per te deshmuar se ka realizuar pune te ngjashme ne perputhje me % e marre persiepr ne akt marreveshjen e bashkepunimit.

Operatori ka paraqitur kontraten e realizuar si BOE se bashku me Sireta 2 F shpk me objekt Rikonstruksion rruga Ismail Qemali e rruga Veterani , me Bashkine Pogradec.

Ne formularin e vleresimit nuk percaktohet % e ndarjes se punimeve ndermjet ketyre dy operatoreve qe ti mundesohej KVO te vleresonet permbushjen e kriterit per pune te ngjashme ne perputhje me % e marre persiper ne akt marreveshje .

Në paragrafin e fundit të shtojcës 12 thuhet se “Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

1.5 Në preventivin e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është percaktuar zeri 5% , duke ndryshuar strukturën e preventivit, duke bërë të pamundur vlerësimin e ofertes se paraqitur me mangësi në formularin e ofertes

Në Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit , është percaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e percaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, ndryshimi i preventivit të ofertes sjell s’kualifikim të saj

Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.

2. BOE “2 Z KONSTRUKSION” shpk & “I.C.C GROUP” shpk

Arsyeja e skualifikimit:

Nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të vecanta për kualifikim të shtojcës 12 e DST

Konkretisht

2.1 Një prej pjesëtarëve të këtij BOE , konkretisht ICC Group shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të deshmuar plotësimin e pikës 8 të kriterëve të vecanta për kualifikim . (nuk ka arritur të deshmojë se disponon licencë QKL për transport mbeturinash kodë;III2B)

Sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit , operatori ICC Group shpk ka marrë përsipër të kryejë 100 % punime që lidhen me transportin e inerteve që krijohen gjatë zbatimit të punëve. . Kjo natyrë punimesh kërkon disponimin e Licenses kodë III.2.B

Në pikën 3 të VKM 914/2014 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të percaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim , të percaktuara në aktm arrëveshje”.**

Pika 8 e kriterëve të vecanta për kualifikim bën pjesë tek kriteret që duhet përmbushur nga secili prej anëtarëve të BOE në përputhje me natyrën dhe % e punimeve të marra përsipër në akt marrëveshjes së bashkëpunimit .

Në rregullat e prokurimit është e percaktuar qartë se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri për kualifikim përben shkak për skualifikim të ofertes.

2.2 Nje prej pjesetareve te ketij BOE , konkretisht ICC Group shpk , nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte qe te deshmoje plotesimin e pikes 2.1.gj te kriterëve te vecanta per kualifikim , shtojca 12 e DST .

Ne kete pike eshte kerkuar ;Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri , operatori ka paraqitur vertetimin e leshuar nga OSHE nr 72prot date 12.01.2021, ne te cilin deshmohet se ; sipas kekreses se bere nga subjekti ICC Group shpk per kontraten me kod TR 2L020181192392 , perdorues i te ciles eshte z Eduart Zoi , rezulton se ka 0 lek detyrime per faturat e energjise elektrike .

Pra nga vertetimi i paraqitur deshmohet se personi fizik z Eduart Zoi nuk ka detyrime per energjine po nuk deshmohet per subjektin ICC Group. Nderkohe qe ofertues ne kete procedure prokurimi eshte personi juridik ICC Group shpk dhe jo individi qofte ky edhe administratori i shoqerise . Ligji per shoqerite tregtare 9901/2008 por edhe K Civil bejne dallim te qarte ndermjet nje personi juridik i rregjistruar si shpk dhe administratorit te ketij personi juridik . Personi juridik identifikohet me NIPT e shoqerise dhe jo emrin e administratorit .

Ne rregullat e prokurimit percaktohet qarte se , është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi apo kerkese per sqarim .

Bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë .

2.3 Nje prej pjesetareve te ketij BOE , konkretisht ICC Group shpk , nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte qe te deshmoje plotesimin e pikes 2.3.4/d te kriterëve te vecanata per kualifikim , shtojca 12 e DST.

Ne kete pike eshte kerkuar ;

d. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne liste pagesat e shoqërisë te pakten muajin e fundit 6 (gjashte) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik leshuar nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, te akredituara sipas legjislacionit ne fuqi, si dhe deshmi te kualifikimit profesional ku nga keta te jene te pakten:

-2(dy) hidraulike, 1(hidroizolues), 3 (tre kartpentiere), (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit profesional, deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) si dhe te jene ne liste pagesen e shoqerise per muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri me perjashtim te profesionit hidraulik ky operator ka paraqitur deshmi te leshuara nga AQSCERT shpk, edhe pjesetari tjetër i ketij BOE , ka paraqitur deshmi te leshuara nga AQSCERT shpk.

Keto deshmi te leshuara nga Aqscert shpk e te paraqitura nga operatori jane te pavlefshme sepse shoqeria ASQCERT, nuk eshte licensuar nga ana Ministrise se Financave dhe Ekonomise dhe nuk disponon asnje license per te ofruar kurse trajnimi per formimin profesional ne perputhje me ligjin nr.15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise." Ne kete rast KVO I referohet vendimit te KPP 441/2020 ku theksohet se ; fq 20 e vendimit...

...citoj Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe të Aftësimit Profesional, nëpërmjet shkresës nr. 17969/1 prot., datë 05.10.2020 me objekt "Kthim përgjigje", bën me dije se: "Ne përgjigje të shkresës tuaj nr.944/3 prot, date 25.09.2020, protokolluar me tonen me nr.17969 prot., date 28.09.2020 me objekt "Kerkese per informacion" ju bejme me dije se pas verifikimeve te kryera rezulton se, shoqeria ASQCERT, nuk eshte licensuar nga ana Ministrise se Financave dhe Ekonomise dhe nuk disponon asnje license per te ofruar kurse trajnimi per formimin profesional ne perputhje me ligjin nr.15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise".

2.4 BOE nuk ka arritur te paraqese dokumentacion per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.4.e te kriterëve te vecanta per kualifikim .

Ne kete pike eshte kerkuar ;

- Operatori duhet te paraqese kontrata pune te vlefshme, dhe deshmi te aftesimit profesional (DAP) se bashku me lejet e drejtimit (patente)per se paku 3 manovratore te mjeteve te renda ; (Eskavatorist/ automakinist / buldozerist) te paisur me deshmit e sigurimit teknik e leshuar nga ISHTI ose instucionet ekuivalente me te, te akredituara sipas ligjislacionit ne fuqi.

Rezulton se dokumentacion i rregullt dhe i sakte eshte paraqitur per vetem dy manovratore dhe keta vetem nga njeri prej pjesetareve te BOE kurse operatori 2Z konstrukcion shpk ndonese ka marre persiper te kryeje 50 % te punimeve nuk ka paraqitur asnje manovrator. . Certifikata e leshuar nga AQSCERT shpk per manovrator sic shpjeguam me siper eshte e pavlefshme .

2.5 Nje prej pjesetareve te ketij BOE, operatori ICC Group shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion qe te deshmoje plotesimin e pikes **2.3.3** te kriterëve te vecanta per kualifikim .

Ne kete pike eshte kerkuar : **2.3.3 Per te provuar se ka pervojen e duhur, Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar mesatarisht të paktën 16 punonjes, për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të deshmuar me; Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**

Rezulton se nga dokumentacioni qe ky operator ka paraqitur ne sistem nuk eshte paraqitur vertetimi ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Në paragrafin e fundit të shtojcës 12 thuhet se "Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim"

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."

3. **BAJRAMI N shpk** me NIPT K02727202O, me oferte ekonomike 13.939.197,3 (trembedhjetë milion e nentëqind e tridhjetë e nente mijë e njëqind e nentëdhjetë e shtatë)leke pa tvsh.

Arsyeja e skualifikimit :

Kërkesë për tërheqje nga procedura e prokurimit.

4. **BOE Loshi BL shpk & Agbes Konstruksion shpk & Delia Impex shpk**

Arsyeja e skualifikimit :

- *Nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim shtojca 12 e DST .*

Konkretisht ;

4.1 Një prej pjesëtarëve të këtij BOE , Loshi BL shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e pikës 2.2.c të kriterëve të vecanta për kualifikim të shtojca 12 e DST (nuk ka paraqitur vertetim për pagesën e taksave vendore për çdo njësi vendore ku ka zhvilluar aktivitet).

Ne këto pike është kërkuar :

Vërtetim për shlyerjen e taksave e detyrime vendore, për vitin 2019 dhe kesteve të maturuara të vitit 2020, të lëshuar prej seciles prej njësisve të vetqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, sipas përcaktimeve e afateve në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

(Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).

Për të deshmuar plotësimin e këtij kriteri operatori ka paraqitur vertetim nga NJQV Prrrenjas ku ka edhe seline .

Nga dokumentacioni i paraqitur në SEP por edhe nga verifikimi në www.qkb.gov.al ,ekstrakti historik i QKBse rezulton se Loshi BL shpk për periudhën 09.08.2018 deri më 21.10.2019 ka ushtruar aktivitet edhe në LIBRAZHD; *me vendodhje ; Truall me sipërfaqe 200m2, nr pasurisë 1/569, Vol. 22, Fq. 100, zona kadastrale nr. 2446.*

Por për këto vend zhvillimi aktivitetit nuk ka arritur të paraqesë vertetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 për periudhën që ka ushtruar aktivitet në këto njësi.

Sipas ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, taksat duhet të paguhën për çdo vend zhvillimi biznesi.

Madje KPP nuk ka vijuar me shqyrtimin e arsyeve të tjera të skualifikimit sepse ka konsideruar se mospagimi i taksave vendore nga njëri prej pjesëtarëve të BOE për një pjesë të periudhës së kërkuar në DT , është shkak i mjaftueshëm për skualifikim pa qenë nevoja për arsye të tjera skualifikimi.

4.2 Një prej pjesëtarëve të këtij BOE, Loshi BL shpk i cili sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë persiper të kryeje 53 % të punëve, nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të

sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.4/d te kritereve te vecanata per kualifikim , shtojca 12 e DST.

Ne kete pike eshte kerkuar ;

d. *Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne liste pagesat e shoqërisë te pakten muajin e fundit 6 (gjashte) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik leshuar nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, te akredituara sipas legjislacionit ne fuqi, si dhe deshmi te kualifikimit profesional ku nga keta te jene te pakten:*

-2(dy) hidraulike, 1(hidroizolues), 3 (tre kartpentiere), (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit profesional, deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) si dhe te jene ne liste pagesen e shoqerise per muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri , operatori ekonomik Loshi BL sh.p.k ka paraqitur në SEP vetem kontratat e punes dhe deshmi te sigurimit teknik por jo deshmi aftesimi profesional ne profesionet e kerkuara hidraulike, hidroizolues dhe kartpentiere .

KVO vlereson se, operatori nuk e përmbush kriterin e përcaktuar 2.3.4/d te kritereve te vecanata per kualifikim te shtojca 12 e DST ne proporcion me % dhe natyren e punimeve qe ka marre persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit, për paraqitjen e punonjësve të kualifikuar, pasi me anë të deshmitë te sigurimit teknik, operatorët ekonomikë nuk provojnë që punonjësit e kërkuar janë të kualifikuar profesionalisht në specialitetet e kërkuara.

Ne kete rast , KVO ka zbatuar praktiken e vendimarrjes se KPP , si organi me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve publike, vendimet e te cilit jane te detyrueshme per zbatim nga cdo AK qe prokuron fonde publike. Konkretisht VENDIM K.P.P. 706/2019 ku operatori MANE S shpk eshte skualifikuar pikerisht dhe vetem per arsyen qe po skualifikohet edhe ky BOE. Po keshu edhe vendimi KPP.343/2020 ,etj.

4.3 Nje prej pjesetreve te ketij BOE , Loshi BL shpk i cili sipas akt marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper te kryeje 53 % te puneve , nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.6 te kritereve te vecanata per kualifikim , shtojca 12 e DST.Numri dhe lloji i makinerive qe operatori Loshi Bl ka deklaruar per disponim per kete procedure nuk permbush as numrin e as llojin e makinerive qe do duhje te kishte ne proporcion me natyrne dhe % e puneve te marra persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit.

Ne pikën 3 te VKM 914/2014 parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim*”

apo fu r n iz im , të për caktu ar a n ë aktm arr ëves h je”.

Pika 2.3.6 e kriterëve të vecanta për kualifikim bëjnë pjesë të kriterëve që duhen përmbushur nga secili prej anetarëve të BOE në përputhje me natyrën dhe % e punimeve të marra për sipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit.

Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **OE “HASTOÇI shpk** me NIPT J62028009B me adresë Tiranë Tiranë TIRANË Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Pjeter Bogdani, Pallati nr.17, Apartamenti 5/3, përballë Kopshtit nr.31, me administrator Z. Mynyr Hastoçi, se oferta e paraqitur prej tij me një vlerë prej 15.156.729 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e nente) leke pa tvsh, **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Përrrenjas sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.01.2021

Ankesa: Jo.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
NURI BELBA**

**NE MUNGËSE DHE ME URDHER
ZV/KRYETARI
ALBAN ÇEKREZI**

Pranoi: Z.Cekrezi-Përgjegjese Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike
Konceptoi: Albana. Kopaci Specialiste /Juriste
Merita Rira Specialiste /Juriste